



Prishtinë, 20 dhjetor 2011
Kodi i ZRRE-së: V_385_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Shkresën / Njoftimin e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A të datës 1 dhjetor 2011 lidhur me vendimin e tyre për të mos aplikuar për ngritjen e tarifave;

në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2011/2012, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

Arsyetim

1. Me datën 1 dhjetor 2011, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH. A, me anë të së cilës njoftohet ZRRE-ja se, menaxhmenti i NQ Termokos, në koordinim me Bordin e drejtorëve, ka marrë vendim që të mos aplikoj për ngritjen e tarifave për sezonin 2011/2012. Në këtë njoftim gjithashtu theksohen edhe arsytet për një vendim të tillë:
 - Rikthimi i besimit të konsumatorëve, i cili është cenuar gjatë sezonit të kaluar kur NQ Termokos ka dështuar që t'ju siguroj konsumatorëve furnizim të qëndrueshëm dhe kualitativ;
 - Rritja e tarifave në këtë situatë do të ndikonte negativisht në arkëtimin e pagesave nga konsumatorët – përkundrazi, është vlerësuar se zbatimi i tarifave ekzistuese bashkë me furnizimin e përmirësuar do të ndikoj pozitivisht në shtimin e shkallës së arkëtimit të pagesave.
 2. Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Termokosit të datës 1 dhjetor 2011, të cilat i ka konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
 3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Termokos të datës 1 dhjetor 2011, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Termokos SH. A për sezonin e ngrohjes 2011/2012 është dhënë në tabelën e mëposhtme:**



TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A.
PËR SEZONIN E NGROHJES 2011/2012

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.06 [€/m ² për muaj]	0.08 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.78 [€/m ² për muaj]	0.92 [€/m ² për muaj]

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A.	
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.70 [€/kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	45.50 [€/MWh]

- III. NQ Termokos SH. A duhet ta publikojë këtë vendim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos SH.A. për të verifikuar realizimin e të Ardhurave dhe Kostove në sezonin 2011/2012.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Enver Halimi, Anëtar